


Mejushke

MBËSHTJELLËSI I LËNDËS

Shtojca 11 – Mbështjellësi i Lëndës

01-1352

02.07.2021



Akti – lënda vendoset në a.a.

Shernja e klasifikimit

Lënda : ANKESË NDAË NJOFTIMIT PUBLIK

05-350/02-78983/21

BANOROT E RR. G. MAJOR- KRESHTNIK OSERKA

Lëndët e zgjidhura njëkohësisht nr.

Numri i ruajtur dhe afati i ruajtjes

Numri nga libri intern i dorëzimit 1483

Afati:

Zgjidhja e lëndës:


aprovim / refuzim

01-879/21

Data:/...../.....

E përpunoi :

vendi



PËR: DREJTORINË E URBANIZMIT/KOMUNËN E PRISHTINËS
Prishtinë, 30.06.2021

Lënda: Ankesë/përgjigje ndaj Njoftimit Publik (kërkesës me nr. 05-350/02-78983/21) të datës 05.05.2021

Me datën 16.06.2021 keni shpallur Njoftimin publik duke e informuar publikun se në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa nr. 05-350/02-78983/21 e datës 05.05.2021, e pronarit Besnik Asllani përmes së cilës kërkohet përcaktimi i kritereve të caktuara për ndërtimin e ndërtesës banimore-afariste, me etazhitet 2B+P+5, në parcelat kadastrale nr. 6528 dhe 6529 ZK Prishtinë, në kuadër të planit rregullues "Dodona" dhe PZHU.

Në këtë njoftim na është dhënë mundësia që të komentojmë mbi këtë propozim deri më 01.07.2021.

Ne, banorët e poshtënëshkruar, jemi përballë ndërtesës e cila parashihet të ndërtohet në këto parcela, respektivisht banojmë në rrugën "Gustav Majer", B. 33 që i bie të jetë përballë dhe në kufirin e parcelave në fjalë. Njoftimin e tillë e kemi parë rastësisht dhe as që jemi kontaktuar nga pronari apo dikush tjetër.

Me këtë letër ne shprehim kundërshtimin e plotë dhe pakënaqësinë e madhe me këtë ndërtim. Si është e mundur që të ndërtohet banesë në hapësirë kaq të vogël, e madje të hapet bodrum, duke e rrezikuar kështu tërë ndërtesën tonë e me këtë edhe jetërat tona. Gjithashtu ky ndërtim me këto kritere aspak të përshtatshme prej 2,5 metrash nga vija rregulluese do të thotë që neve na cenohet fillimisht drita e diellit e më pas edhe privatësia në banesat tona dhe natyrisht zhurma që më pas do të krijohet do të na lërë pa gjumë, sidomos fëmijët tanë dhe me brenga tërë jetën. Ky plan rregullues shndërrohet në plan shkatërrues dhe natyrisht se do të bëjmë çmos që të ndalojmë këtë ndërtim aspak në përputhje me kriteret dhe ligjet e aplikueshme, madje jo vetëm që do të lajmërojmë policinë por edhe do të vazhdojmë deri në instancat më të larta.

Nëse kjo ndërtohet sipas këtyre kritereve aspak ligjore dhe aspak humane, dhe meqë ballkonet dhe dritaret tona i bie të jenë përballë kësaj ndërtese pothuaj me distancë shumë të vogël, për ne banorët e kësaj ndërtese, do të: mbyllet tërësisht pamja, nuk do të kemi mundësinë të shijojmë rrezet e diellit, do të rrezikohen themelet e kësaj banese e cila do të kishte pasoja të mëdha si dhe mjedisi do të shkatërrohet me zhurma e ndotje. Duhet theksuar se në këtë shpallje nuk është llogaritur aspak ndotja e mjedisit, të cilën ju e keni shënuar me JO, që në fakt nëse fillon ndërtimi, jeta do të bëhet e padurueshme si dhe e drejta e ndriçimit natyror ju e keni shënuar me PO, që në fakt është një JO e madhe. Si mund të gjej njeriu qetësinë më pas?!

Bazuar në Ligjin mbi Ndërtim nr. 04/L-110, fillimisht me nenin 4, paragrafi 1.1 mbrojtja e shëndetit dhe e sigurisë, parimet mbi lëshimin e lejes ndërtimore, shkelen në tërësi.

Pastaj, neni 18 i po këtij ligji parasheh përcaktimin e kushteve ndërtimore, si në vijim: 1. Nëse nuk ekziston plani rregullativ urban, aplikuesi i propozon organit kompetent kushtet ndërtimore që dalin mbi

bazën e diametrit prej pesëdhjetë (50) metrave nga vijat kufizuese të parcelës tokësore për të cilën aplikuesi ka kërkuar të ndërtoj objektin e tij ndërtimor, pra këtu nuk bëhet fjalë për 50 metra por vetëm për 10 metra, pra është në kundërshtim të plotë me këtë dispozitë ligjore.
















Pika 2. Në rast kur nuk ekziston plani rregullues urban, organi kompetent njofton publikun dhe mundëson komentet për kërkesën e dhënies së lejes së ndërtimit, siç edhe kemi vepruar.

Sipas Udhëzimit Administrativ 06/2017, mbi përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje ndërtimi për kategorinë I dhe II, ne do të përcjellim vendosjen e kësaj ankese në ueb faqen e Komunës së Prishtinës në përputhje me nenin 13, pika 2 dhe 3.

Ne besojmë fuqishëm se organi juaj kompetent nuk do të lejojë një ndërtim të tillë të egër që është në kundërshtim jo vetëm me ligjin por edhe me parimet e një jete të lirë dhe pa brenga.

Ju lutem konfirmoni pranimin e kësaj ankese të dërguar me e-mail.

Banorët (pronarë) që kanë kundërshtuar këtë ndërtim janë si më poshtë:

- Valdete Bunjaku 
- Shefki Oseku 
- Granit Fazliu 
- Nexhdet Roka 
- Xhevrije Bajrami 
- Mustafa Destani 
- Fahredin Vejsa 
- Florent Berisha 
- Kreshnik Oseku 
- Hysni Hasani 
- Zyrafete Krasniqi 
- Hamide Maxhuni 
- Nëntor Fetiu 
- Luan Qorraaj 
- Gazmend Mehmeti 

044-236-037



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina – Municipality of Prishtina

Njoftim publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa nr. 05-350/02-78983/21 dt. 05.05.2021, e pronarit Besnik Asllani, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtimin e ndërtesës banimore-afariste, me etazhitet 2B+P+5, në parcelat kadastrale nr.6528 dhe 6529 ZK.Prishtinë, në kuadër të Planit Rregullues "Dodona" dhe PZHU.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 16.06.2021 deri më 01.07.2021, në E-mail adresën: urbanizmi@prishtine@rks-gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Tokë ndërtimore
b. Vija rregulluese	Vija e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike
c. Vija ndërtimore	2.5 m nga vija rregulluese
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	18.00m / 2.5 m' (veri-perendim përgjatë rrugës ekzistuese në terren)
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	18.00/ 1.00 m' dhe 18.00m / 4.50m' (jug-perendim dhe veri-lindje) 18.00m / 6.60 m' (jug-lindje)
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	40 %- e lejuar ~ 40% i propozuar
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	ISPN 2.5 - i lejuar 2.5 - i propozuar
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40 % e kërkuar 30% e propozuar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	60%
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	14
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zonë të mbrojtura, zonë të veçanta ose zonë të veçanta të mbrojtura? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rënimimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafet 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.
Në të gjitha komentet tujja duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë.

Nënshkrimi i Zyrtarit:



Komuna e Prishtinës
Drejtorja e Urbanizimit
Adresa: "Rr. Dëshmorët", nr.11, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: 045 221 412 e-mail: urbanizimi@prishtine@rks-gov.net



